



Kur rregullatori shkel rregullat: Kundërligjshmëria e gjobave të KPM-së ndaj shkeljeve të mediave

			3	4
	8	9	10	11
14	15	16	17	18
21	22	23	24	25
28	29	30	31	

JASHTË AFATIT

**PA KOMPETENCË
TË RREGULLT**

Autorë: Gzim Shala dhe Betim Musliu

Redaktor: Ehat Miftaraj

Me kontribut të veçantë të: Florian Smajli

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Qershor, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Vendimet sanksionuese të KPM-së për fushatat zgjedhore.....	10
3. Vendimmarrja e pasafatshme.....	14
4. Kundërligjshmëria e procedurës vendimmarrëse	17
5. Përfundime	22
6. Rekomandime	24
Aneksi 1 – Vendimet e KPM lidhur me fushatat zgjedhore të vitit 2025	25
Aneksi 2 – Vendimet e KPM lidhur me fushatën zgjedhore 2026	28

Lista e shkurtesave

IKD	–	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KPM	–	Komisioni i Pavarur i Mediave
LPPA Administrative	–	Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme
OShM	–	Ofruesit e Shërbimeve Mediale
OShMA Audiovizuale	–	Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
Rregullorja KPM-2024/03	–	Rregullorja për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore
Rregullorja KPM-2024/01	–	Rregullorja për Procedurën e Trajtimin të Ankesave në Komisionin e Pavarur të Mediave
Rregullorja KPM-2023/02	–	Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio dhe Audiovizuale
Kodi i Etikës KKPM-2016/03	–	Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale

1. Përmbledhje ekzekutive

Komisioni i Pavarur i Mediave (tutje: KPM) është institucion i pavarur kushtetues, përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave audio dhe audiovizuale në Kosovë. Gjatë fushatës zgjedhore është e rëndësishme që ky mekanizëm të jetë funksional në mënyrë që të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore. Monitorimi i mediave nga KPM ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së mediave gjatë procesit zgjedhor, informimin e qytetarëve, barazinë e subjekteve politike dhe në integritetin e vet procesit zgjedhor. Për këtë arsye, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullorja KPM-2024/03 kanë vendosur rregulla të veçanta për mediat gjatë fushatës zgjedhore, si dhe afate të shkurtuara për trajtimin e shkeljeve eventuale.

Megjithatë, për shkak të dështimit të Kuvendit për të zgjedhur numrin e nevojshëm të anëtarëve në këtë institucion, pikërisht në periudhën kur këto rregulla është dashur të zbatoheshin, KPM ka qenë jofunksionale. Nga 21 janari 2025 deri më 5 maj 2026, për shkak të mungesës së kuorumit, KPM nuk ka pasur mundësi të ushtrojë kompetencat e saj vendimmarrëse. Kjo periudhë ka përkuar me disa procese zgjedhore: zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit 2025, zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025, balotazhin e 9 nëntorit 2025 dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025.

Si rezultat i dështimit të Kuvendit të Kosovës për të emëruar anëtarët e KPM, ky mekanizëm ka qenë jofunksional dhe në pamundësi që të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore.

Përbërja e re e KPM-së është votuar nga Kuvendi më 24 prill 2026.¹ Mbledhjen e parë në përbërje të re, KPM e ka mbajtur më 5 maj 2026, ku ka zgjedhur kryesinë.² Pas funksionalizimit, KPM u është kthyer rasteve të akumuluar nga fushatat zgjedhore të vitit paraprak dhe ka shqiptuar gjoba e vërejtje ndaj mediave kryesisht për shkelje të pretenduara të Rregullores KPM-2024/03.

Me përbërjen e re, pas zgjedhjes së kryesisë, KPM ka mbajtur katër (4) mbledhje, ku ka shqyrtuar 62 raste ligjore, duke shqiptuar sanksione në 59 prej

¹ "Kuvendi votoi përbërjen e re të Komisionit të Pavarur për Media". Betimi për Drejtësi. 24 prill, 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kuvendi-votoi-perberjen-e-re-te-komisionit-te-pavarur-per-media-kpm/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

² "Besnik Berisha zgjidhet kryetar i KPM-së, Drita Morina nënkryetare". Betimi për Drejtësi. 5 maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/besnik-berisha-zgjidhet-kryetar-i-kpm-se-drita-morina-nenkryetare/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

tyre. Nga këto 59 sanksione, në 31 raste janë shqiptuar gjoba në vlerë totale prej 67,000.00 euro, ndërsa në 28 raste janë shqiptuar vërejtje. Në dy mbledhjet e para, KPM shqyrtoi rastet lidhur me proceset zgjedhore të vitit të kaluar, ku shqiptoi 46 sanksione. Prej tyre, 21 me gjoba në vlerë totale prej 43,000.00 euro dhe 25 me vërejtje. Ndërsa, në dy mbledhjet pasuese, KPM shqyrtoi rastet lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. Në këto dy mbledhje pasuese, KPM shqiptoi 13 sanksione, 10 prej tyre me gjoba në vlerë totale prej 24,000.00 euro dhe 3 vërejtje.

Por, ky raport gjen se vendimet sanksionuese të KPM-së për këto raste janë plotësisht të kundërligjshme. Kjo për dy arsye themelore.

Së pari, sa i përket vendimeve lidhur me fushatat e proceseve zgjedhore për Rregulloren KPM-2024/03 gjatë vitit të kaluar, ato janë marrë jashtë afateve të posaçme të përcaktuara me po këtë Rregullore. Kjo Rregullore parasheh afate shumë të shkurta: shqyrtim fillestar brenda katër orëve, përgjigje nga media brenda 24 orëve, shqyrtim pas përgjigjes brenda 24 orëve dhe vendim të KPM-së brenda pesë ditëve gjatë fushatës së rregullt, përkatësisht brenda 60 orëve në zgjedhje të jashtëzakonshme. Këto afate nuk janë vendosur rastësisht. Ato janë vendosur sepse shkeljet gjatë fushatës kanë efekt të menjëhershëm dhe duhet të trajtohen në kohë reale. Vendimi i marrë shumë muaj pas përfundimit të zgjedhjeve nuk e riparon më garën zgjedhore dhe nuk mund ta kthejë funksionin rregullues që duhet ta ketë KPM gjatë fushatës. Për më tepër, vendimmarrja pas një periudhe kaq të gjatë e vë edhe vet median në pozitë të pabarabartë procedurale. Pas shumë muajsh, e aq më tepër pas një viti, media nuk e ka më të njëjtën mundësi reale për t'u mbrojtur, për të rikthyer kontekstin e saktë të transmetimit, për të siguruar përgjigje të shpejtë nga stafi përgjegjës apo për të sqaruar në kohë reale rrethanat e rastit. Për këtë arsye, afatet e shkurta janë vendosur, ndër të tjera, për të mbrojtur palët nga një procedurë e vonuar, ku përgjigja bëhet shumë më e vështirë dhe më pak efektive.

Së dyti, të gjitha vendimet përfshirë ato për fushatat zgjedhore të vitit të kaluar dhe ato për fushatën e zgjedhjeve të parakohshme të këtij viti, janë pa efekt juridik dhe të paligjshme për shkak të procedurës vendimmarrëse. Rregullorja për trajtimin e ankesave e bën rekomandimin e Zyrës Ekzekutive pjesë të domosdoshme të procedurës. Mirëpo, KPM funksionon me ushtrues detyre të kryeshefit ekzekutiv që nga 2 korriku 2021. Fillimisht këtë pozitë e ka ushtruar Faruk Rexhaj, ndërsa nga 24 shtatori 2024 Niman Racaj. Edhe sipas variantit më të favorshëm ligjor, pozita nuk mund të mbahet me ushtrues detyre më gjatë se dy vite. Kjo periudhë ka skaduar më 2 korrik 2023. Pas kësaj date, pozita është mbajtur në kundërshtim me ligjin.

Data 2 korrik 2023 nuk përdoret për të pretenduar se ndryshimi i mëvonshëm ligjor ka efekt prapaveprues, por për të treguar se edhe sipas interpretimit më të favorshëm për KPM-në, pra kufirit maksimal dyvjeçar për mbajtjen e pozitës me ushtrues detyre, ky afat është tejkaluar shumë kohë më parë. Kjo përputhet edhe me standardin e Gjykatës Supreme, sipas të cilit, afati lidhet me pozitën si funksion institucional dhe jo me personin që caktohet ushtrues detyre, prandaj ndërrimi i personit nuk e rifillon afatin.

Gjykata Supreme, në rastin e Autoritetit të Aviacionit Civil, ka vendosur standard të qartë: afati për ushtrues detyre lidhet me pozitën, jo me personin, dhe ndërrimi i personit nuk e rifillon afatin. Sipas këtij standardi, aktet e nxjerra nga një pozitë e mbajtur me ushtrues detyre përtej afatit ligjor janë të pavlefshme për shkak të mungesës së kompetencës ligjore. Ky standard është i aplikueshëm edhe në rastin e KPM-së. Kështu, të gjitha vendimet sanksionuese të shqiptuara nga KPM janë të bazuara në rekomandime të kundërligjshme, sepse janë nxjerrë pa autorizim ligjor.

Përgjegjësia për këtë situatë është institucionale. Kuvendi e ka lënë KPM-në jofunksionale gjatë proceseve zgjedhore, ndërsa KPM për vite të tëra nuk ka arritur ta zgjedhë kryeshefin ekzekutiv në mënyrë të rregullt. Kjo për shkak se para se KPM të mbetej jofunksionale në janar të vitit 2025, ky institucion kishte qenë funksional për rreth një vit e gjysmë, konkretisht nga maji i vitit 2023. Periudhë kohore kjo, gjatë të cilës KPM nuk arriti të zgjedhë kryeshef ekzekutiv, por ndërroi vetëm ushtruesin e detyrës. Më 24 shtator 2024, KPM kishte zëvendësuar Faruk Rexhajin që kishte qenë duke ushtruar këtë pozitë qysh nga korriku i vitit 2021, me Niman Racaj, i cili është duke ushtruar këtë pozitë edhe aktualisht.³

Andaj, këto dështime nuk mund të shërohen me vendime të kundërligjshme ndaj mediave. Ligji duhet të zbatohet edhe ndaj mediave, por së pari duhet të zbatohet nga institucioni që i sanksionon ato.

³ "KPM edhe pas tri vitesh me u.d. kryeshef ekzekutiv, tani e zëvendëson me një tjetër". Betimi për Drejtësi. 24 shtator 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-edhe-pas-tri-vitesh-me-u-d-kryeshef-ekzekutiv-tani-e-zevendeson-me-nje-tjeter/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

2. Vendimet sanksionuese të KPM-së për fushatat zgjedhore

KPM është institucioni përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e fushës së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale. Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM [neni 3], ndër të tjera, ky institucion ka kompetencë të vendosë sanksione ndaj subjekteve të licencuara të cilat shkelin rregulloret e Komisionit apo kushtet e licencës.

Në periudhë zgjedhore, ky rol bëhet edhe më i rëndësishëm. Mediat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si qytetarët informohen për subjektet politike, kandidatët, programet dhe aktivitetet e fushatës. Për këtë arsye, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret e KPM-së kanë vendosur rregulla të veçanta për mediat gjatë fushatës zgjedhore. Këto rregulla kanë për qëllim të ruajnë barazinë e garës, transparencën e reklamimit politik dhe informimin e drejtë të qytetarëve.

Në këtë drejtim, KPM ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03.⁴ Kjo rregullore është akt i posaçëm. Ajo nuk rregullon një situatë të zakonshme, por një periudhë të veçantë: fushatën zgjedhore. Për këtë arsye, ajo ka përcaktuar si obligime të veçanta për mediat, ashtu edhe afate të veçanta për trajtimin e shkeljeve të pretenduara.

Në këtë pikë duhet theksuar se Instituti i Kosovës për Drejtësi (tutje: IKD) ka qenë drejtpërdrejt i përfshirë në procesin e hartimit të kësaj Rregulloreje.⁵ Me kërkesë dhe në mbështetje të KPM-së, IKD ka ndihmuar pro bono në draftimin e plotë të Rregullores KPM-2024/03, e cila pastaj është shqyrtuar dhe miratuar nga KPM pas procesit të konsultimeve publike me grupe të interesit përfshirë mediat dhe partnerët ndërkombëtarë.

Për këtë arsye, IKD e njeh mirë jo vetëm tekstin e kësaj rregulloreje, por edhe qëllimin për të cilin bashkërisht me KPM janë vendosur afatet procedurale. Këto afate nuk janë vendosur si afate orientuese apo dekorative, por si mekanizëm për të siguruar reagim të menjëhershëm gjatë fushatës zgjedhore, kur shkeljet eventuale mund të prodhojnë efekt real në procesin zgjedhor. Për më tepër drejtësia administrative funksionon mbi parimet e sundimit të ligjit

⁴ "KPM miraton Rregulloren e cila përcakton obligimet e mediejeve gjatë fushatës zgjedhore". Betimi për Drejtësi. 16 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-miraton-rregulloren-e-cila-percakton-obligimet-e-mediejeve-gjate-fushates-zgjedhore/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

⁵ Po aty.

vetëm duke u respektuar ligji, qëllimi i ligjit, procedura dhe afatet e përcaktuara ligjore apo administrative.

Mirëpo, zbatimi i kësaj rregulloreje gjatë vitit 2025 është përballur me një problem themelor institucional. KPM, që nga 21 janari 2025 e deri më 5 maj 2026, kur pas emërimit të përbërjes së re zgjedhi kryetarin dhe nënkryetaren, për shkak të mungesës së kuorumit, ka qenë jofunksional. Në këtë periudhë kohore, në Kosovë janë zhvilluar disa procese zgjedhore. Ndërsa, Kuvendi nuk e ka funksionalizuar me kohë përbërjen e KPM-së. Si pasojë, organi që është dashur të reagojë gjatë fushatës zgjedhore nuk ka pasur mundësi të marrë vendime brenda afateve të përcaktuara me po këtë rregullore.

Kjo nuk është çështje teknike procedurale. Nëse rregullatori nuk funksionon në kohën kur zhvillohet fushata, atëherë edhe shkeljet eventuale të mediave nuk trajtohen në kohë. Në një demokraci, kjo krijon dëm të dyfishtë: fillimisht, sepse mbikëqyrja e procesit zgjedhor nuk ndodh kur duhet të ndodhë dhe më pas, sepse institucioni tenton t'i kthehet këtyre rasteve pas shumë muajsh, kur afatet dhe efekti zgjedhor tashmë kanë kaluar. Përgjegjësia për këtë situatë bie mbi Kuvendin, i cili nuk e ka mbajtur funksional KPM-në, por edhe mbi KPM-në, e cila pas konstituimit ka vepruar sikur afatet e përcaktuara nga vet ajo nuk kanë ekzistuar.

Përbërja e re e KPM-së është votuar nga Kuvendi më 24 prill 2026.⁶ Mbledhjen e parë KPM e ka mbajtur më 5 maj 2026,⁷ ku ka zgjedhur kryesinë e re. Kryetar i KPM-së është zgjedhur Besnik Berisha, ndërsa nënkryetare Drita Morina. Pas kësaj, KPM ka filluar shqyrtimin e rasteve të akumuluar, të cilat kishin të bënin me shkeljet e pretenduara të mediave gjatë proceseve zgjedhore të vitit 2025.

Në mbledhjen e datës 15 maj 2026, KPM ka shqyrtuar rastet e iniciuara ex officio si dhe ankesat e palëve gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të datës 9 shkurt 2025.⁸ Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar gjithsej 26 raste ligjore. Nga këto raste, 17 kishin të bënin me shkeljen e Rregullores KPM-2024/03.

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar gjithsej 11 gjoba në vlerë totale prej 23,000 euro, 12 masa vërejtjeje, ndërsa tri (3) raste janë refuzuar. Megjithatë, jo të

⁶ "Kuvendi votoi përbërjen e re të Komisionit të Pavarur për Media". Betimi për Drejtësi. prill, 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kuvendi-votoi-perberjen-e-re-te-komisionit-te-pavarur-per-media-kpm/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

⁷ "Besnik Berisha zgjidhet kryetar i KPM-së, Drita Morina nënkryetare". Betimi për Drejtësi. 5 maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/besnik-berisha-zgjidhet-kryetar-i-kpm-se-drita-morina-nenkryetare/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

⁸ "Njoftim nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Mediave". Komisioni i Pavarur i Mediave. 15 maj 2026. (Shih linkun: <https://www.kpm-ks.org/NewsDetails/23/814>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

gjitha këto gjoba lidhen vetëm me Rregulloren KPM-2024/03. Sipas të dhënave, lidhur me shkeljet e Rregullores KPM-2024/03, në këtë mbledhje janë shqiptuar nëntë (9) gjoba në vlerë totale prej 19,000 euro, shtatë (7) vërejtje, kurse një rast është refuzuar.

Pra, shuma prej 23,000 euro i referohet totalit të gjobave në atë mbledhje, ndërsa shuma prej 19,000 euro i referohet gjobave që lidhen me Rregulloren zgjedhore.

Ndërsa, nga 17 rastet që kishin të bënin me shkeljen e Rregullores KPM-2024/03, në gjashtë (6) prej tyre përfshiheshin edhe shkelje të akteve tjera.

Në mbledhjen pasuese, KPM ka shqyrtuar rastet e shkeljeve të evidentuara gjatë monitorimit të mediave, si dhe ankesat e paraqitura nga palët gjatë zgjedhjeve lokale, balotazhit dhe zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme të 28 dhjetorit 2025.⁹

Në këtë mbledhje janë shqyrtuar gjithsej 23 raste. Prej tyre, 22 kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të Rregullores KPM-2024/03, e pesë (5) prej tyre përveç kësaj rregulloreje, pretendohet se kanë bërë shkelje edhe të akteve tjera.

Shuma totale e gjobave nga shqyrtimi i 23 rasteve në këtë mbledhje, është 20 mijë euro, derisa u shqiptuan edhe 13 vërejtje. Ndërsa, nëse llogariten vetëm 22 rastet që kanë të bëjnë me Rregulloren KPM-2024/03, shuma e gjobave është 18,000.00 euro.

Ndërsa, në dy mbledhjet pasuese,¹⁰ KPM shqyrtoi rastet lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. Nga, 13 rastet e shqyrtuara, 12

⁹ "KPM shqipton 20 mijë euro gjoba dhe 12 vërejtje ndaj mediave për shkeljet gjatë zgjedhjeve lokale e atyre të jashtëzakonshme më 2025". Betimi për Drejtësi. 25 maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-shqipton-20-mije-euro-gjoba-dhe-12-verejtje-ndaj-mediave-per-shkeljet-gjate-zgjedhjeve-lokale-e-atyre-te-jashtezakonshme-me-2025/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026); "Njoftim nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Mediave". Komisioni i Pavarur i Mediave. 25 maj 2026. (Shih linkun: <https://www.kpm-ks.org/NewsDetails/23/819>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

¹⁰ "Shkejet e mediave gjatë fushatës zgjedhore, KPM shqipton 12 mijë euro gjoba dhe një vërejtje". Betimi për Drejtësi. 1 qershor 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shkejet-e-mediave-gjate-fushates-zgjedhore-kpm-shqipton-12-mije-euro-gjoba-dhe-nje-verejtje/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026); "KPM shqipton gjoba në vlerë totale prej 12 mijë euro dhe dy vërejtje". Betimi për Drejtësi. 5 qershor 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-shqipton-gjoba-ne-vlere-totale-prej-12-mije-euro-dhe-dy-verejtje/>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026); "Njoftim nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Mediave". Komisioni i Pavarur i Mediave. 5 qershor 2026. (Shih linkun: <https://www.kpm-ks.org/NewsDetails/23/828>). (Qasur për here të fundit më 6 qershor 2026); "Njoftim nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Mediave". Komisioni i Pavarur i Mediave. 1

prej tyre kishin të bënin me Rregulloren KPM-2024/03, përfshirë dy raste ku përveç për shkelje të kësaj Rregulloreje, gjobat u shqiptuan për shkelje edhe të akteve tjera. Në këto dy mbledhje pasuese, për 13 raste, KPM shqiptoi 13 sanksione, 10 prej tyre me gjoba në vlerë totale prej 24,000.00 euro dhe 3 vërejtje.

Pra, KPM pas konstituimit, u është kthyer rasteve që kishin të bënin me proceset e kaluara zgjedhore, përfshirë zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit 2025, zgjedhjet lokale, përfshirë balotazhin dhe zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit 2025. Pra, kemi të bëjmë me vendime sanksionuese të nxjerra në vitin 2026 për shkelje të pretenduara të ndodhura gjatë fushatave zgjedhore të vitit paraprak.

KPM ka kompetencë ligjore për të shqiptuar sanksione ndaj subjekteve të licencuara që shkelin rregulloret e saj. Mirëpo, kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet jashtë ligjit dhe jashtë procedurës. Kompetenca për të sanksionuar nuk është kompetencë e pakufizuar me ligj dhe rregullore. Ajo duhet të ushtrohet në pajtim me ligjin, me rregulloret e vet KPM-së, me afatet e përcaktuara për procedurën përkatëse dhe me garancitë procedurale që vlejné për palët.

Në rastin konkret, këto vendime sanksionuese të KPM-së për fushatat zgjedhore janë plotësisht të kundërligjshme për dy arsye themelore. E para, sa i përket fushatave nga proceset zgjedhore të vitit 2025, vendimet janë të kundërligjshme sepse janë nxjerrë pas kalimit të afateve të posaçme të përcaktuara me Rregulloren KPM-2024/03.

Ndërsa, të gjitha vendimet përfshirë ato lidhur me shkeljet e pretenduara gjatë fushatave të proceseve zgjedhore të vitit të kaluar dhe ato të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026, janë të kundërligjshme, sepse janë nxjerrë mbi bazën e një procedure vendimmarrëse në të cilën rol të domosdoshëm ka pasur Zyra Ekzekutive. Derisa për vite të tëra është udhëhequr nga ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv, përtej afateve kohore të lejuar me ligj.

Kështu, të gjitha këto vendime sanksionuese, janë vendime haptazi të kundërligjshme.

Për këtë situatë, përgjegjësia institucionale është e dyfishtë. Kuvendi e ka lënë KPM-në jofunksionale në një periudhë kur vendi ka kaluar nëpër disa procese

qershor 2026. (Shih linkun: <https://www.kpm-ks.org/NewsDetails/23/825>). (Qasur për herë të fundit më 6 qershor 2026).

zgjedhore. Ndërkaq, KPM, pasi është funksionalizuar nuk ka ndërmarrë masa efektive për emërimin e kryeshefit ekzekutiv duke e lënë KPM-në jofunksionale në kuptim të menaxhimit apo administrimit të përditshëm të saj nga zyrtarë publikë që në bazë ligjit të kenë autorizime ligjore fuqiplota për vendimmarrje. KPM me këtë qasje nuk është kufizuar në nxjerrjen e mësimëve nga kjo situatë, por ka vendosur të shqiptojë sanksione për raste të cilat nuk janë trajtuar brenda afateve të posaçme ligjore dhe rregullative. Dështimi i Kuvendit e ka krijuar problemin. Mënyra se si KPM ka vendosur pas konstituimit ka gjeneruar gjyba të kundërligjshme për ofruesit e shërbimeve mediale.

Për këto arsye, çështja nuk është nëse mediat kanë pasur apo jo përgjegjësi për shkeljet e pretenduara gjatë fushatave zgjedhore. Çështja është nëse KPM ka mundur ligjërisht t'i sanksionojë ato në këtë mënyrë, në këtë kohë dhe mbi bazën e kësaj procedure. Siç do të argumentohet në kapitujt vijues, përgjigjja është negative. Vendimet në fjalë janë haptazi të kundërligjshme, sepse janë rezultat i vendimmarrjes së pasafatshme dhe i një procedure të bazuar në rekomandime të nxjerra pa autorizim ligjor. Si të tilla, janë vendime haptazi të kundërligjshme.

3. Vendimmarrja e pasafatshme

Komisioni i Pavarur i Mediave, që nga 21 janari 2025 e deri më 5 maj 2026, kur pas emërimit të përbërjes së re zgjodhi kryetarin dhe nënkryetaren, për shkak të mungesës së kuorumit, ka qenë jofunksional.¹¹ Kjo situatë ka përkuar me një periudhë kur në Kosovë ka pasur vazhdimisht procese zgjedhore. Gjatë kësaj kohe janë mbajtur:

- 1) zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 9 shkurt 2025;
- 2) zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025;
 - a. balotazhi i datës 9 nëntor 2025
- 3) zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025.

Ndërkaq, pas konstituimit të KPM-së, është zhvilluar edhe procesi zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të datës 7 qershor 2026. Kështu, përjashtimisht një pjesë të fushatës së zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 dhe

¹¹ "Besnik Berisha zgjidhet kryetar i KPM-së, Drita Morina nënkryetare". Betimi për Drejtësi. 5 maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/besnik-berisha-zgjidhet-kryetar-i-kpm-se-drita-morina-nenkryetare/>). (Qasur për here të fundit më 6 qershor 2026).

periudhën pas konstituimit për zgjedhjet e 7 qershorit 2026, në proceset tjera zgjedhore KPM ka qenë jofunksionale.

Pas konstituimit, KPM nuk ka trajtuar vetëm raste të reja. Përkundrazi, siç u tha, ajo retroaktivisht u është kthyer rasteve të akumuluar gjatë fushatave zgjedhore të vitit paraprak, duke shqiptuar gjopa dhe vërejtje për shkelje të pretenduara të Rregullores KPM-2024/03.

Kjo mënyrë e veprimit bie ndesh me vet Rregulloren KPM-2024/03. Kjo është rregullore e posaçme, e nxjerrë në mbështetje të Kapitullit VIII të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. E njëjta përcakton obligimet e veçanta të OShM-ve gjatë një periudhe të veçantë, fushatës zgjedhore. Për shkak të veçantisë që ka, ajo ka rregulluar si obligimet e veçanta për OShMA-të ashtu edhe afatet e veçanta për jetësimin e këtyre obligimeve.

Sipas nenit 19 të Rregullores KPM-2024/03, procedura e trajtimit të ankesave për shkelje të kësaj rregulloreje zhvillohet sipas Rregullores për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM, ndërsa për këto ankesa KPM aplikon afate të shkurtuara kohore sipas nenit 20 të saj. Neni 20 pastaj i përcakton këto afate në mënyrë të qartë dhe strikte:

- 1) shqyrtimi fillestar bëhet brenda katër orëve nga pranimi i ankesës;
- 2) afati i OSHM-së për përgjigje është 24 orë;
- 3) shqyrtimi pas përgjigjes apo pas skadimit të afatit për përgjigje bëhet brenda 24 orëve;
- 4) shqyrtimi i ankesës dhe vendimi i KPM-së duhet të përfundojnë më së largu brenda pesë ditëve nga pranimi i ankesës gjatë fushatës së rregullt zgjedhore. Në rastet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ky afat shkurtohet në 60 orë.

Këto afate nuk janë vendosur rastësisht. Ato janë vendosur sepse shkeljet gjatë fushatës zgjedhore kanë efekt të menjëhershëm mbi garën zgjedhore, mbi barazinë e subjekteve politike dhe mbi informimin e qytetarëve. Për këtë arsye, reagimi i KPM-së duhet të jetë në kohë reale. Vendimi i marrë shumë muaj pas përfundimit të zgjedhjeve nuk mund ta kthejë barazinë e cenuar, nuk mund ta riparojë informimin e gabuar dhe nuk mund të ndikojë më në integritetin e procesit zgjedhor. Në atë moment, vendimi nuk është më mjet rregullues zgjedhor, që si të tillë e paraqet vet fryma e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mbi bazën e të cilit është nxjerrë Rregullorja në fjalë.

Argumenti i KPM-së se afatet kanë vetëm karakter udhëzues,¹² pasi rregullorja nuk parasheh shprehimisht humbjen e kompetencës vendimmarrëse, nuk mund të qëndrojë. Nëse ky argument pranohet, atëherë e gjithë Rregullorja KPM-2024/03 ka vetëm karakter udhëzues dhe nuk mund të përdoret si bazë për sanksionim. Nuk ka asnjë logjikë juridike që dispozitat materiale të rregullores të jenë të detyrueshme për mediat, ndërsa dispozitat procedurale të së njëjtës rregullore të konsiderohen vetëm udhëzuese për KPM-në. Rregullorja ose zbatohet si tërësi, ose nuk mund të përdoret në mënyrë selektive vetëm për të sanksionuar palët.

Po ashtu, nuk mund të pranohet as argumenti se mosfunksionaliteti i KPM-së e ka pezulluar rrjedhjen e afateve. Një përjashtim i tillë nuk është paraparë as me ligj dhe as me rregullore. Ligjshmëria nuk mund të varet nga rrethanat e brendshme organizative të organit administrativ.

Në këtë kuptim, sipas nenit 52.1.1.3. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative. Në rastin konkret, vendimet e KPM-së janë rezultat i një procedure të zhvilluar jashtë afateve të posaçme të përcaktuara në ditë dhe në orë nga KPM. Për këtë arsye, vendimet sanksionuese në fjalë, sipas nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative janë qartazi vendime të kundërligjshme.

Duhet theksuar se, me qëllim të respektimit të po këtyre afateve, vet Rregullorja KPM-2024/03 ka paraparë masa të veçanta. Neni 23 përcakton se, me qëllim të zbatimit të dispozitave të rregullores sipas afateve të parapara, KPM ndërmer masa të veçanta. Këto masa hyjnë në fuqi një javë para fillimit të fushatës zgjedhore dhe përfundojnë pas mbylljes së procesit zgjedhor. Për më tepër, paragrafi 4 i këtij neni përcakton se masat e veçanta vlejné dhe janë të aplikueshme vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve dhe nuk mund të zbatohen dhe të kenë efekt ligjor pas mbylljes së procesit zgjedhor.⁷ Kjo dispozitë e vërteton edhe një herë se e gjithë logjika e kësaj rregulloreje është e lidhur me kohën e zgjedhjeve, jo me vendimmarrje retroaktive pas kalimit të afateve ligjore.

Për fund, duhet theksuar se kjo situatë nuk është krijuar nga mediat. Është krijuar nga dështimi i Kuvendit për ta mbajtur funksional institucionin e pavarur kushtetues që ka për detyrë të mbikëqyrë mediat gjatë fushatës zgjedhore. Kur KPM nuk ka kuorum dhe nuk mund të vendosë në kohën kur zhvillohet fushata, atëherë edhe shkeljet eventuale të mediave mbesin pa trajtim në kohë reale.

¹² UD kryeshefi ekzekutiv i KPM-së - Mbledhja e KPM e mbajtur më 15 maj 2026.

Kjo është humbje për procesin zgjedhor dhe për demokracinë. Jo pse mediat domosdoshmërisht kanë vepruar drejt në secilën situatë, por sepse institucioni që është dashur të reagojë në kohë nuk ka qenë në gjendje ta bëjë këtë.

Mirëpo, dështimi i Kuvendit për ta funksionalizuar KPM-në nuk mund të shërohet me vendime të kundërligjshme të KPM-së pas shumë muajsh. Nëse ka pasur shkelje gjatë fushatës, ato është dashur të trajtohen brenda afateve të rregullores dhe në kohën kur vendimi do të kishte kuptim për procesin zgjedhor. Kur kjo nuk ka ndodhur, përgjegjësia është institucionale. Por kjo përgjegjësi nuk i jep KPM-së të drejtë që, pas kalimit të afateve, ta krijojë një procedurë të re dhe të sanksionojë sikur afatet nuk kanë ekzistuar fare, duke abstrahuar përgjegjësinë e Kuvendit në dëm të mediave përmes kundërligjshmërisë.

4. Kundërligjshmëria e procedurës vendimmarrëse

Përveç vendimmarrjes së pasafatshme, vendimet sanksionuese të KPM-së kanë edhe një problem tjetër të pavarur juridik. Ky problem lidhet me vet procedurën mbi bazën e së cilës janë nxjerrë këto vendime. Më saktësisht, lidhet me rolin e Zyrës Ekzekutive dhe të kryeshefit ekzekutiv në përgatitjen, trajtimin dhe rekomandimin e rasteve para Komisionit.

Sipas nenit 19 të Rregullores KPM-2024/03, procedura e trajtimit të ankesave për shkelje të kësaj rregulloreje zhvillohet sipas Rregullores për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM, me afate të shkurtuara sipas nenit 20 të Rregullores zgjedhore. Kështu, vet Rregullorja zgjedhore e bën pjesë të procedurës së saj edhe Rregulloren Nr. 2024/01 për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM. Për këtë arsye, ligjshmëria e vendimeve sanksionuese nuk mund të vlerësohet vetëm nga dispozitivi i vendimit final, por edhe nga ligjshmëria e procedurës që i ka paraprirë atij vendimi.

Rregullorja Nr. 2024/01 e përcakton qartë rolin e Zyrës Ekzekutive në këtë procedurë. Sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje, ankesat e parashtruara trajtohen nga Zyra Ekzekutive, përkatësisht Departamenti Ligjor dhe Divizioni i Ankesave, ndërsa vendosen nga KPM. I njëjti nen përcakton se në mbledhjet e KPM-së, ankesat dhe të gjeturat prezantohen nga Kryeshefi i Zyrës Ekzekutive. Po ashtu, sipas nenit 22 të kësaj Rregulloreje, pas shqyrtimit të ankesës, zyrtari i Divizionit të Ankesave përpilon rekomandimin mbi rezultatet e procedurës ankimore; rekomandimi përmban të dhënat lidhur me ankesën, procedurën e ndjekur, veprimet e ndërmarra, faktet dhe provat e shqyrtuara, gjetjet, vlerësimet përfundimtare dhe propozimin për vendimin që duhet ta marrë KPM. Për më

tepër, rekomandimi mbi trajtimin e ankesës, përmes kryeshefit ekzekutiv, u dërgohet anëtarëve të KPM-së.

Pra, rekomandimi nuk është një shkresë formale dhe e parëndësishme. Ai është pjesë integrale e procedurës vendimmarrëse. Është dokumenti mbi bazën e të cilit KPM shqyrton rastin dhe vendos. Këtë e konfirmon edhe neni 23 i Rregullores Nr. 2024/01, sipas të cilit KPM, gjatë mbledhjes, shqyrton rekomandimet e pranuar sipas nenit 22 të kësaj Rregulloreje. Kështu, procedura e KPM-së nuk mund të ndahet artificialisht në dy pjesë: një pjesë ku Zyra Ekzekutive përgatit, dhe një pjesë ku Komisioni vendos. Vendimi final është produkt i gjithë zinxhirit procedural.

Në këtë situatë merr rëndësi statusi juridik i kryeshefit ekzekutiv të KPM-së. KPM funksionon me ushtrues detyre të kryeshefit ekzekutiv që nga 2 korriku 2021. Fillimisht, në këtë pozitë ishte caktuar Faruk Rexhaj.¹³ Më 24 shtator 2024, KPM e zëvendësoi Faruk Rexhajn me Niman Racajn, duke e caktuar këtë të fundit ushtrues detyre të Kryeshefit Ekzekutiv.¹⁴ Kështu, nuk bëhet fjalë për një situatë të përkohshme disa mujore, por për një pozitë të lartë drejtuese, e cila për vite të tëra mbahet me ushtrues detyre.

Sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda këtij afati, ai mund të zgjatet më së shumti edhe për gjashtë muaj të tjerë. Pra, sipas ligjit bazik, afati maksimal ishte 12 muaj. Më pas, me Ligjin Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ky regjim u ndryshua, duke u përcaktuar se zyrtari publik nuk mund të caktohet ushtrues detyre më gjatë se 12 muaj, përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur, por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar. Megjithatë, edhe sipas këtij ligji, pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se dy vite.

Në të dy variantet ligjore, situata në KPM është e kundërligjshme. Para ndryshimit të ligjit, kufiri maksimal ishte 12 muaj. Pas ndryshimit të ligjit, edhe në interpretimin më të favorshëm për KPM-në, kufiri maksimal për pozitën është dy vite. Duke qenë se pozita e kryeshefit ekzekutiv të KPM-së mbahet me ushtrues

¹³ "KPM edhe pas tri vitesh me u.d. kryeshef ekzekutiv, tani e zëvendëson me një tjetër". Betimi për Drejtësi. 24 shtator 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-edhe-pas-tri-vitesh-me-u-d-kryeshef-ekzekutiv-tani-e-zevendeson-me-nje-tjeter/>). (Qasur për here të fundit më 6 qershor 2026);

"Tre ditë pas arrestimit të Kryeshefit të KPM-së, emërohet zëvendësues i tij". Ekonomia Online. 2 korrik 2021. (Shih linkun: <https://ekonomiaonline.com/tre-dite-pas-arrestimit-te-kryeshefit-te-kpm-se-emerohet-zevendesues-i-tij/>) (Qasur për here të fundit më 6 qershor 2026).

¹⁴ Po aty.

detyre që nga 2 korriku 2021, edhe sipas variantit më të butë ligjor, afati maksimal dyvjeçar është tejkaluar më 2 korrik 2023. Kjo do të thotë se të gjitha veprimet procedurale dhe rekomandimet e dhëna pas kësaj date janë zhvilluar në një situatë ku pozita përkatëse është mbajtur në kundërshtim me ligjin.

Në këtë pikë, rëndësi ka aktgjykimi i Gjykatës Supreme, P.A.nr.07/2025, i datës 10 qershor 2025. Në këtë rast, Gjykata Supreme vlerësoi ligjshmërinë e një rregulloreje të nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit të AAC-së, në një kohë kur pozita ishte mbajtur me ushtrues detyre përtej afatit ligjor. Gjykata Supreme theksoi se sipas Ligjit çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit ligjor është i pavlefshëm, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë.

Më tutje, Gjykata Supreme e qartësoi edhe një çështje tjetër të rëndësishme: afati nuk lidhet me personin, por me pozitën. Sipas Gjykatës Supreme, ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Për këtë arsye, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo do të thotë se zëvendësimi i Faruk Rexhajt me Niman Racajn nuk e ka "shëruar" kundërligjshmërinë dhe nuk e ka rifilluar afatin nga zero.¹⁵

Ky standard i Gjykatës Supreme është drejtpërdrejt i aplikueshëm edhe në rastin e KPM-së. Nëse një pozitë udhëheqëse mbahet me ushtrues detyre përtej afatit të lejuar me ligj, atëherë personi që ushtron atë pozitë nuk mund të ndërmarrë asnjë akt apo veprim procedural me efekt juridik. Në rastin konkret, të gjitha veprimet e ndërmarra në kuadër të kësaj pozite, përfshirë edhe rekomandimet e Zyrës Ekzekutive të dërguara përmes kryeshefit ekzekutiv, janë të kundërligjshme. Kjo për faktin se, pas kalimit të afatit ligjor, ajo pozitë juridikisht nuk mund të ushtrohet, sikurse ka ndodhur në rastin konkret. Rrjedhimisht, pas kalimit të këtij afati, nga kjo pozitë nuk mund të ndërmerret asnjë veprim i vlefshëm juridik.

Ndërkaq, siç u theksua më lart, rekomandimet e Zyrës Ekzekutive janë pjesë e domosdoshme e procedurës së vendimmarrjes së KPM-së. Nëse pozita përmes së cilës këto rekomandime procedohen dhe u dërgohen anëtarëve të KPM-së mbahet në kundërshtim me ligjin, atëherë edhe rekomandimet e tilla janë të kundërligjshme. Si rrjedhojë, të gjitha vendimet sanksionuese që trajton kjo

¹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme - , P.A.nr.07/2025.

analizë janë nxjerrë mbi bazën e një procedure të kundërligjshme dhe, për këtë arsye, edhe vetë ato janë të kundërligjshme.

Siç u tha, pa rekomandim, Komisioni nuk do ta kishte mundësi të vendoste. Për këtë arsye, paligjshmëria e rekomandimit e bën vendimin e KPM të kundërligjshëm, për shkak se bazohet në një rekomandim të kundërligjshëm.

Kjo argumentohet drejtpërdrejt me nenin 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Sipas këtij neni, një akt administrativ është i paligjshëm nëse është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, nëse organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë, apo nëse është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative.⁹ Në rastin konkret, vendimet e KPM-së janë të cenuara nga të tri këto baza. Ato

- 1) janë nxjerrë mbi bazën e rekomandimeve që nuk mund të konsiderohen të ligjshme, sepse kanë kaluar përmes një pozite të mbajtur në kundërshtim me ligjin;
- 2) janë rezultat i një procedure ku një hallkë esenciale nuk ka pasur kompetencë të rregullt ligjore për të ushtruar funksionet e pozitës; dhe
- 3) janë rezultat i shkeljes së dispozitave procedurale që rregullojnë trajtimin dhe rekomandimin e rasteve.

Në këtë kuptim, sipas standardit të Gjykatës Supreme, rekomandimi i dalë nga një pozitë e mbajtur me ushtrues detyre përtej afatit ligjor nuk mund të trajtohet si rekomandim juridikisht i vlefshëm. Ai nuk mund të prodhojë efekt si akt procedural juridikisht i rregullt. Si rrjedhojë, vendimi që mbështetet mbi një rekomandim të tillë është i ndërtuar mbi një bazë të kundërligjshme.

Për këto arsye, të gjitha vendimet sanksionuese të KPM-së të marra mbi bazën e rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive pas kalimit të afatit ligjor për mbajtjen e pozitës së kryeshefit ekzekutiv me ushtrues detyre janë të kundërligjshme. Edhe në variantin më të favorshëm për KPM-në, pra duke aplikuar kufirin maksimal dyvjeçar, kjo periudhë ka përfunduar më 2 korrik 2023. Pas kësaj date, rekomandimet e dala përmes kësaj pozite janë rekomandime të prodhuara në kundërshtim me ligjin. Kjo është baza e dytë, e pavarur, pse të gjitha vendimet sanksionuese të KPM-së për fushatat zgjedhore janë të kundërligjshme.

Duhet theksuar se edhe kjo situatë nuk është krijuar nga palët në procedurë. Është krijuar nga vet KPM, e cila për vite të tëra nuk ka arritur ta zgjedhë kryeshefin ekzekutiv përmes procedurës së rregullt ligjore. Ky mosveprim i KPM ka sjellë deri tek kjo situatë, ku Zyra Ekzekutive e KPM udhëhiqet kundërligjshëm.

KPM nuk mund të kërkojë respektim të ligjit nga mediat, përmes vendimeve të nxjerra pa autorizim ligjor, përderisa ajo vetë ka dështuar për vite me radhë. Ligji nuk mund të zbatohet vetëm ndaj subjekteve që sanksionohen. Ai duhet të zbatohet së pari nga institucioni që sanksionon. Nëse KPM nuk e ka përmbushur detyrimin e saj për ta zgjedhur kryeshefin ekzekutiv në mënyrë të rregullt dhe brenda kufijve ligjorë, atëherë pasojat e këtij dështimi nuk mund të mbulohen me vendime sanksionuese. Për këtë dështim, KPM vetë duhet të ofrojë llogaridhënie publike dhe jo të shkel ligjin në dëm të ofruesve të shërbimeve mediale.

5. Përfundime

1. KPM ka qenë jofunksionale nga 21 janari 2025 deri më 5 maj 2026, në një periudhë kur në Kosovë janë zhvilluar disa procese zgjedhore. Për shkak të mungesës së kuorumit, institucioni që ka përgjegjësi të mbikëqyrë mediat gjatë fushatës nuk ka mundur të marrë vendime në kohën kur shkeljet eventuale është dashur të trajtoheshin.
2. Pas funksionalizimit, KPM u është kthyer rasteve të akumuluar nga fushatat zgjedhore të vitit 2025 dhe ka shqiptuar gjoha e vërejtje në vitin 2026. Pra, vendimet sanksionuese janë marrë shumë muaj pas përfundimit të zgjedhjeve dhe pas kalimit të kohës kur ato vendime do të kishin efekt real në procesin zgjedhor.
3. Rregullorja KPM-2024/03 nuk është rregullore e zakonshme, por rregullore e posaçme zgjedhore, e cila ka përcaktuar jo vetëm obligimet e mediave gjatë fushatës, por edhe afate të posaçme për trajtimin e shkeljeve. Këto afate janë vendosur për të siguruar reagim të menjëhershëm gjatë fushatës, jo vendimmarrje retroaktive pas shumë muajsh.
4. Afatet e Rregullores KPM-2024/03 nuk mund të trajtohen si udhëzuese për KPM-në dhe si detyruese për mediat. Nëse Rregullorja përdoret si bazë për sanksionim, atëherë ajo duhet të zbatohet si tërësi. KPM nuk mund të marrë vetëm pjesën ndëshkuese të Rregullores, duke shpërfillur pjesën procedurale të saj.
5. Vendimet sanksionuese të KPM-së janë të kundërligjshme për shkak se janë marrë jashtë afateve të posaçme dhe si rezultat i një procedure të zhvilluar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2024/03. Në kuptim të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ është i paligjshëm kur është rezultat i shkeljes së dispozitave procedurale.
6. Vendimet sanksionuese janë të kundërligjshme edhe për shkak të procedurës vendimmarrëse. Rekomandimet e Zyrës Ekzekutive janë pjesë e domosdoshme e procedurës, ndërsa Zyra Ekzekutive e KPM-së për vite të tëra është udhëhequr nga ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv përtej afateve të lejuara me ligj.
7. Sipas standardit të Gjykatës Supreme, afati për ushtrues detyre lidhet me pozitën dhe jo me personin. Andaj, zëvendësimi i Faruk Rexhajt me Niman Racajn nuk e ka rifilluar afatin dhe nuk e ka shëruar kundërligjshmërinë e mbajtjes së pozitës së Kryeshefit Ekzekutiv me

ushtrues detyre përtej afatit ligjor. Si rrjedhojë, të gjitha veprimet e ushtruesit të detyrës pas kalimit të afatit ligjor, përfshirë edhe rekomandimet që janë bazë e vendimeve sanksionuese, janë vendime pa efekt juridik. Kështu, vendimet sanksionuese janë bazuar në rekomandime të nxjerra pa efekt juridik.

8. Kjo situatë është pasojë e dështimit institucional. Kuvendi nuk e ka mbajtur funksionale KPM-në gjatë periudhës zgjedhore, ndërsa KPM nuk e ka zgjedhur kryeshefin ekzekutiv në mënyrë të rregullt. Megjithatë, këto dështime nuk mund të mbulohen me gjopa të kundërligjshme ndaj mediave. Ligji duhet të zbatohet së pari nga institucioni që sanksionon.

6. Rekomandime

1. KPM duhet t'i rishqyrtojë sipas detyrës zyrtare vendimet sanksionuese të marra për shkeljet e pretenduara gjatë fushatave zgjedhore të vitit 2025.
2. KPM duhet t'i anulojë apo shfuqizojë vendimet që janë nxjerrë jashtë afateve të posaçme të Rregullores KPM-2024/03 dhe mbi bazën e një procedure të bazuar në rekomandime të kundërligjshme.
3. KPM duhet të heqë dorë nga interpretimi se afatet e Rregullores KPM-2024/03 kanë vetëm karakter udhëzues. Afatet e procedurës zgjedhore duhet të zbatohen njësoj si ndaj mediave, ashtu edhe ndaj vetë KPM-së.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të sigurojë që KPM të mos mbetet pa kuorum funksional në asnjë moment.
5. KPM duhet ta përfundojë pa vonesë procedurën për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv dhe ta ndërpresë praktikën shumëvjeçare të udhëheqjes së Zyrës Ekzekutive me ushtrues detyre.
6. KPM duhet të publikojë një sqarim të plotë institucional për arsyet pse rastet zgjedhore të vitit 2025 nuk janë trajtuar brenda afateve dhe pse pozita e kryeshefit ekzekutiv vazhdon të mbahet me ushtrues detyre përtej afateve ligjore.
7. Nëse KPM nuk reflekton, mediat e sanksionuara duhet t'i ndjekin rrugët ligjore në dispozicion, për të sfiduar vendimet e kundërligjshme sanksionuese të nxjerra nga KPM.

Aneksi 1 – Vendimet e KPM lidhur me fushatat zgjedhore të vitit 2025

Nr	Data e mbledhjes	Media	Shkelja e aktit	Vendimi
1	15/05/2026	TV Arbëria	KPM-2024/03	Vërejtje
2	15/05/2026	ATV	KPM-2024/03	Vërejtje
3	15/05/2026	DTV	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
4	15/05/2026	Kanal 10	KPM-2024/03	Vërejtje
5	15/05/2026	Kanal 10	KPM-2024/03	Gjobë 3,000 euro
			Rregullores KPM-2023/02	
6	15/05/2026	Klan Kosova	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Gjobë 1,000.00 euro
7	15/05/2026	Klan Kosova	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
8	15/05/2026	Klan Kosova	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	
9	15/05/2026	KTV	KPM-2024/03	Refuzohet
10	15/05/2026	Plus TV	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Refuzohet
11	15/05/2026	RTK1	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
12	15/05/2026	RTK2	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
			KPM-2024/03	
13	15/05/2026	RTV21	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
			KPM-2023/02	
14	15/05/2026	TE7	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
15	15/05/2026	TE7	KPM-2024/03	Gjobë 4,000.00 euro
			KPM-2023/03	
			Kodit të Etikës KKPM-2016/03	
16	15/05/2026	TëVë1	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro

			KPM-2023/03	
17	15/05/2026	RTV21	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Refuzohet
18	15/05/2026	TV Dukagjini	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
19	15/05/2026	TV Dukagjini	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Vërejtje
20	15/05/2026	TV Dukagjini	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Gjobë 3,000.00 euro
21	15/05/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
22	15/05/2026	TV Most	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
23	15/05/2026	TV Opinion	KPM-2024/03	Vërejtje
24	15/05/2026	Puls TV	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
25	15/05/2026	TV Syri Vision	KPM-2024/03	Vërejtje
26	15/05/2026	TV Zëri	KPM-2024/03	Vërejtje
27	25/05/2026	Rtv Malisheva	KPM-2024/03	Vërejtje
28	25/05/2026	TV Llapi	KPM-2024/03	Vërejtje
29	25/05/2026	Kanal 10	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	
30	25/05/2026	Klan Kosova	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	
31	25/05/2026	Klan Kosova	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
32	25/05/2026	KTV	KPM-2024/03	Vërejtje
33	25/05/2026	KTV	KPM-2024/03	Vërejtje
34	25/05/2026	RTK1	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
35	25/05/2026	RTK2	KPM-2024/03	Vërejtje
36	25/05/2026	TëVë1	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
37	25/05/2026	TV21	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
38	25/05/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	

39	25/05/2026	TV Dukagjini	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Gjobë 2,000.00 euro
40	25/05/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Vërejtje
41	25/05/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Vërejtje
42	25/05/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Vërejtje
43	25/05/2026	TV Mir	KPM-2024/03	Vërejtje
44	25/05/2026	TV Most	KPM-2024/03	Vërejtje
45	25/05/2026	TV Puls	KPM-2024/03	Vërejtje
46	25/05/2026	TV Syri Vision	KPM-2024/03	Vërejtje
47	25/05/2026	TE7	KPM-2024/03	Gjobë 4,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	
48	25/05/2026	TV Syri Vision	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
			KPM-2023/02	
			Kodi i etikës KKPM-2016/03	
49	25/05/2026	ATV	KPM-2024/03	Vërejtje

Aneksi 2 – Vendimet e KPM lidhur me fushatën zgjedhore 2026

Nr	Data e mbledhjes	Media	Shkelja e aktit	Vendimi
1	01/06/2026	TE7	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
2	01/06/2026	Kanal 10	KPM-2024/03	Gjobë 4,000.00 euro
3	01/06/2026	Klan Kosova	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
4	01/06/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
			KPM-2023/02	
5	01/06/2026	TëVë1	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
			KPM-2023/02	
6	01/06/2026	ATV	KPM-2024/03	Vërejtje
7	05/06/2026	Kanal 10	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
8	05/06/2026	TV Dukagjini	KPM-2024/03	Vërejtje
9	05/06/2026	TV Syri Vision	KPM-2024/03	Vërejtje
10	05/06/2026	Klan Kosova	KPM-2024/03	Gjobë 1,000.00 euro
11	05/06/2026	TE7	KPM-2024/03	Gjobë 3,000.00 euro
12	05/06/2026	TV21	KPM-2024/03	Gjobë 2,000.00 euro
13	05/06/2026	TV Most	Kodi i etikës KKPM-2016/03	Gjobë 3,000.00 euro

